



Npi – 01/313 datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) si dhe nenin 17 shkronja (k dhe l) të Ligjit Nr.03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Statutin e Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/990 të datës: 20.09.2024 për ndarjen e parcelës për Banim të Përballueshëm dhe Social; Si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa; Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2024, miratoi këtë:

## V E N D I M

### **PËR NDARJEN E 11052 m<sup>2</sup> SIPËRFAQE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PROJEKTIN E BANIMIT TË PËRBALLUESHËM DHE SOCIAL**

#### I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 27.09.2024, me shumicën e votave miratoi, Vendimin për ndarjen e sipërfaqes prej 11052 m<sup>2</sup>, (1 hektar, 10 ari e 52 metra) truall për ndërtimin e objekteve sipas projektit të Qeverisë të Republikës së Kosovës për Banim të Përballueshëm dhe Social, në Ngastrën Kadastrale, me numër: P-72809093-03052-2, Zona Kadastrale – Shtime, Kualiteti i klasës “Kullojë e klasës 4”, Evidentuar në emër të “Komuna e Shtimes”.

#### II

A r s y e t i m: Kuvendi ka marrë vendim sikurse në dispozitiv, duke marrë për bazë problemet e banimit në Komunën e Shtimes si një sfidë e papërballueshme për shumë kategori shoqërore, sikurse janë çiftet e reja, gratë kryefamiljare, disa arsimtarë, policë, shërbyes publik, administratë publike e shumë kategori të tjera shoqërore. Propozimit i kanë parapri takimet e komisionit komunal për Banim të Përballueshëm dhe Social dhe komisionit profesional nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë i formuar në kuadër të Programit Qeveritarë ku familjet përfutuese do të bëhen pronarë të banesave me këste mujore të përballueshme për një kohë relativisht të shkurtë. (Programi “150€ X 150 muaj”).

#### III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

#### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi